

WASSERPROOF 1K



PERSHKRIMI

Llaç hidroizolues një komponentësh me bazë çimento.

KARAKTERISTIKAT

Llaç hidroizolues një komponentësh me bazë çimento i cili ofron cilësi të mira izoluese ndaj lagështisë dhe mbron betonin nga karbonizimi. Është i përshtatshëm për tu përdorur në hidroizolim të depozitave që mbajnë ujë të pijshëm, bodrumeve etj. I lehtë në aplikim dhe kosto të ulët aplikimi si dhe nuk ka efekt korroduese për betonet e përforcuara me çelik.

FUSHAT E APLIKIMIT

Hidroizolimi i sipërfaqeve prej betoni, suvasë dhe mureve nga lagështia. I përshtatshëm për hidroizolim të depozitave të ujit, bodrumeve, ambienteve nëntokësore etj. I përshtatshëm për hidroizolim të brendshëm për zonat nëntokësore, si për shembull bodrumeve, pasi i reziston presioneve të larta për shkak të lidhjes shumë të fortë që krijon me suportin.

TE DHENA TEKNIKE

Konsistenca:	Pluhur
Ngjyra:	Gri
Pesha volumore (g/cm³):	1.4
Mbetja e thate (%):	100
Raporti perzierjes me ujë:	25%- 27%
Konsistenca e perzierjes:	Viskoze, aplikim me malle ose furce
Pesha volumore e perzierjes (kg/m³):	1,700
Temperatura e aplikimit:	nga +8°C në +35°C
Koha e punimit:	3 ore
Rezistenca në ngjeshje:	
• Në kushte normale	76 Mpa
• Pas cikleve ngrirje-shkrirje: Rezistenca	72 MPa
Forca ngjete në beton:	
• Kushte normale:	0.8 MPa
• Ciklevë ngrirje-shkrirje:	0.5 MPa
• Zhytjes në ujë:	0.6 MPa
Pershkueshmëria e avujve të ujit EN ISO 7783- 1:	class II: SD < 2,5 m
Papershkueshmëria e ujit, (kg/m². h0.5) EN 1062- 3:	0,09

MËNYRA E PËRGATITJES

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër nga pluhurat, yndyrnat dhe çdo lloj tjetër papastërtie. Nëqoftëse sipërfaqja ku aplikohet Wasserproof 1K ka plasaritje ose të çara, fillimisht kryhet mbyllja e tyre dhe pastaj aplikohet produkti. Nëse sipërfaqja ku aplikohet ka cepa telash të dalë, ato duhet të priten nga 2 deri në 4 cm thellësi dhe pastaj vrima e krijuar mbyllet e më pas aplikohet produkti.

APLIKIMI

Wasserproof 1K shtohet gradualisht në sasinë e kërkuar të ujit nën një përzierje të vazhdueshme derisa të formohet një masë viskoze e përshtatshme për tu aplikuar me furçë. Sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë tërësisht e thatë dhe nuk duhet të ketë gjurmë lagështie. Produkti aplikohet me dy ose më shumë shtresa në varësi të mjedisit ku aplikohet. Çdo shtresë nuk duhet të jetë më shumë se 1mm e trashë për të shmangur plasaritjet dhe shtresa pasardhëse aplikohet mbasi të jetë thatë plotësisht shtresa parardhëse.

SKADENCA

12 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazh origjinal dhe mbrohet nga ngricat dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell..

KONSUMI

2.5- 3 kg/m²

PAKETIMI

Wasserproof 1K është i ambalazhuar në thasë 25 Kg.

